



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e VI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 qershor 2022 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 11:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Drejtorët e drejtorive, Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar, Nexhat Merovci, nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Islam Latifi, koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës, Ismet Gashi, nga zyra ligjore, Haki Maloku, nga zyra e kryetarit, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se kemi katër pika shtesë, të cilat janë propozuar për t'u futur në rend të ditës.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – propozoi që të futet në rend të ditës në mbledhjen e rregullt të kuvendit <Shqyrtimi i vendimit për anulim të konkurseve për drejtorë të shkollave>, e cila për shkak të mungesës së kuorumit nuk u shqyrtua në seancën e jashtëzakonshme.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – sa i përket dy pikave të rendit të ditës të cilat janë kthyer nga ministria, këtu në akt – përcjellës thuhet për çështje procedurale, por ne në kuvend kemi diskutuar për këto dhe janë në pikën zero. Që do të thotë se edhe planifikimi mund të ndryshohet në kuvend.

Ndërkaq, lidhur me propozimin e Sylejmanit, jam kundër këtyre insinuatave, të cilat po mundohen që t'i lansojnë si subjekt politik, për arsye se ne në të kaluarën e dimë se si kanë qeverisur, por asnjëherë nuk kemi thirrur seanca të jashtëzakonshme, sepse kemi konsideruar se është pjesë e qeverisë komunale dhe jo e kuvendit. Kjo çështje po krijon konfuzitet dhe se nuk po jep kurrfarë zgjidhjeje.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – lidhur me propozimin e Sylejmanit, unë jam që të diskutohet në mbledhjen e radhës të kuvendit, sepse thirrja e seancës së jashtëzakonshme ka qenë politike për t'i ndëshkuar disa individë bashkërisht me disa anëtarë të kuvendit. Prandaj, jemi që të diskutojmë në mbledhje të rregullt për anulimin e konkursit për drejtorë, por edhe për çdo problem tjetër.

Alban Tahiraj, i autorizuar i kryetarit të komunës – deklaroi se sa i përket propozimit në fjalë nuk kemi material. Anëtari i komitetit, i cili bëri këtë propozim u ankua për pikat shtesë që mos të procedohen pasi që erdhën me vonesë. Në çdo seancë të rregullt kemi pikë në të ndryshme dhe aty mund të ngritet çdo shqetësim. Kurse, rendin e ditës e përcakton kryesuesja në

bashkëpunim me kryetarin e komunës. Subjekti juaj politik publikisht ka paralajmëruar hapa tjerë ligjor për këtë çështje dhe se konsideroj se është ezauruar si kauzë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se anëtarët e kuvendit e kanë pasur materialin dhe këto janë gjëra publike për të cilat ka folur edhe kryetari i komunës, i cili mes tjerash ka propozuar edhe ndryshimin e komisionit. Nëse veç e ka në plan ta ndërroj komisionit, herët apo vonë do të diskutojmë për këtë çështje. Prandaj, ka vendim publik për anulim të konkursit nga ana e kryetarit dhe nuk shoh të keqe që të vij në rend të ditës përmes KPF-së dhe të diskutohet si pikë e rregullt.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – nuk po e di për çfarë materiali foli Albanezi, dhe se as ai dhe as kryetari nuk mund të na i caktoj pikat e rendit të ditës së kuvendit, sepse ne anëtarët jemi ata që mund t'i heqim dhe t'i fusim ato. Prandaj, kur të shkojmë në kuvend mund të propozohet përsëri dhe të diskutohet për këtë çështje. Prandaj, është këtu një propozim dhe pse mos të shkojë prej KPF-së.

Komiteti për Politikë dhe Financa me katër (4) vota “për”, tri (3) “kundër” dhe një (1) “abstenim” rekomandoi që për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, të futet si pikë e rendit të ditës <Shqyrtimi i vendimit për anulim të konkurseve për drejtorë të shkollave>.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – lidhur me këtë pikë që u rekomandua, atëherë Drejtoria për Arsim në bashkëpunim me qeverinë komunale duhet ta përgatis materialin.

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore – tha se secili anëtar i KPF-së dhe kuvendit në çdo mbledhje ka të drejtë të bëjë propozim për pikë shtesë që të futet në rend të ditës. Për mua është diskutabile që kuvendi ta fus në rend të ditës, sepse kjo çështje nuk u diskutua fare në KPF madje as në rend të ditës nuk hyri, sepse u rekomandua që të futet si pikë e rendit të ditës në kuvend. Kjo mund të shkojë si rekomandim, por nuk është obligative që ta trajtojë kuvendi, sepse prapë duhet t'i nënshtrohet një votimi në kuvend, tha ai. Unë e kuptova z. Mehulli, i cili kërkoi që të diskutohet këtu në KPF, por për shkak se materiali mungonte, kjo mund të merret si rekomandim, por nuk është obligim, sepse nuk është shqyrtuar fare këtu.

Albanez Tahiraj, i autorizuar i kryetarit të komunës – po e shoh një praktikë të re që një pikë të rekomandohet për kuvend pa u shqyrtuar fare në KPF dhe madje as nuk u votua që të trajtohet këtu.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – tha se nëse doni me gjetur nërskamca gjejmë sa të doni, por kjo pikë u votua që të diskutohet këtu dhe të rekomandohet për kuvend.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – deklaroi se unë nuk jam për nërskamca këtu, por besoj që as të tjerët. Mund të ndodhë ndonjë keqkuptim ose keqinterpretim, por Sylejman Mehulli kërkoi që KPF-ja të rekomandojë që të jetë pikë e veçantë në seancën e radhës (të rregullt) të kuvendit kjo çështje. Unë kështu e kuptova kërkesën e Sylejmanit dhe kështu edhe doli në votim. Kjo do të shkojë si rekomandim, e morëm edhe opinionin e zyrës ligjore dhe vazhdojmë tutje.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – theksoi se propozimi im ishte i qartë dhe me mirëkuptim e shtrova. I falënderoj kolegët nga LDK-ja që e kuptuan drejtë këtë. Nuk kemi tendencë ndaj askujt dhe qëllimi është që të diskutojmë për këtë çështje. Prandaj, diskutimi është çështja më

elementare e kuvendit dhe ti si kryesuese duhet që ta mbrosh këtë vlerë të demokracisë. Nëse nuk diskutojmë në kuvendin komunal, atëherë jemi të obliguar dhe të detyruar të shkojmë në procedura tjera që parashihen. Prandaj, e keni obligim që t'i procedoni gjërat që kalojnë me shumicë votash në KPF. Unë e pata një propozim që të hyjë në rend të ditës në seancën e radhës të rregullt të kuvendit, anëtarët e KPF-së e votuan dhe këtu jemi para një akti të kryer. A e procedon ti si kryesuese apo nuk e procedon, kjo është çështje e juaja se si do të vendosni. Për mua kjo çështje ka përfunduar, sepse përfundoi edhe diskutimi, por edhe votimi.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – tha se unë jam këtu që të punojmë sipas ligjit. Në momentin që e kuptoj se nuk jam duke punuar sipas ligjit dhe kam bërë shkelje ligjore, unë largohem nga kjo pozitë. Kjo pikë nuk diskutohet në KPF, por në seancën e rregullt të kuvendit, kjo ishte edhe kërkesa jote. Nëse mendon që këtu ka nërskamca, të ftoj në sekretari ta dëgjosh propozimin tënd se si e ke shtruar. Këtu ka ndodhur një keqkuptim, LDK-ja po mendon që duhet të diskutohet edhe në KPF, e ne bashkë po mendojmë që të diskutohet në seancën e radhës. Nuk është keqkuptimi në mes meje dhe teje, por në mes VV-së dhe LDK-së.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12.5.2022;
2. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2023-2025 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë;
3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat;
4. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021;
5. Shqyrtimi i Raportit dhe grantit të performancës për vitin 2020;
6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të ndërtimeve pa leje;
7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë gjatë periudhës janar – qershor 2022;
8. Rishqyrtimi i vendimit nr. 95/22 i datës 28.4.2022 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021;
9. Rishqyrtimi i vendimit nr. 96/22 i datës 28.4.2022 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;
10. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12.5.2022.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 12.5.2022.

2. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2023-2025 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2023/01 e kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore. Ky është një dokument që përmban prioritetet strategjike lidhur me caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023 – 2025 është në përputhje me udhëzimet e

dhëna me Qarkoren Buxhetore 2023/01, e nxjerrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – lidhur me takimet publike me qytetarë për buxhetin, ajo tha se KPF e harton kalendarin kohor. Ne e kemi të përgatitur materialin, por vetëm duhet që ta plotësojmë. Në grupet punuese duhet të përfshihet një anëtar i KPF-së, një zyrtar nga buxheti, por mund të marrin pjesë të gjithë anëtarët tjerë të kuvendit.

Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar – theksoi se në kalendar iu kisha sugjeruar që ta fusim mbajtjen e një takimi publik me komunitetin e biznesit.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se ka qenë një dakordancë e përbashkët kur e kemi votuar buxhetin, ku me një zotim të kryetarit të na njoftojë për projektet (sidomos për rrugët specifiku, të cilat do të asfaltohen gjatë këtij viti). Neve si anëtarë të kuvendit dhe KPF-së, akoma nuk na ka ardhur lista e projekteve, se për cilat rrugë kanë vendosur drejtoritë përkatëse. Prandaj, kërkoj nga drejtoritë përkatëse që të na sjellin listën e rrugëve, të cilat do të asfaltohen, si dhe listën e rrugëve me kubëza gjatë këtij viti në qytet dhe fshatra. Prandaj, sa herë kemi qenë në dëgjime buxhetore, kërkesat kryesore të komunitetit kanë qenë rrugët që do të asfaltohen, kurse ne nuk e dimë se cilat rrugë janë planifikuar për asfaltim. Për hir të transparencës dhe zotimit të kryetarit, është mirë që në kuvend të na sjellin listën e rrugëve ta dimë se ku janë planifikuar, sepse kudo që asfaltohen rrugët është mirë.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – sa u përket palëve të interesit, çdo herë kemi pasur takim dëgjime buxhetore, e jo të ndahen vetëm bizneset, por edhe investitorët e mundshëm. Prandaj, ta caktojmë orarin këtu në KPF që ta dimë se kush do të jetë pjesëmarrës nga ne. Megjithatë, edhe unë pajtohem që të jetë një takim me komunitetin e biznesit dhe fermerët.

Fatmire Cecelia, anëtar i KPF-së – kërkoj që të mbahet një takim me rini dhe komunitetin artistik.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet Draft Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2023-2025 për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

KPF-ja njëzëri caktoi kryesuesit e takimeve publike me qytetarë lidhur me draft – buxhetin për vitin 2023, si në vijim:

Stroc – Ilmi Azemi, kryesues; Druar – Ilmi Azemi, kryesues; Novolan – Melihate Basholli Latifi, kryesuese; Duboc – Nurie Halili, kryesuese; Pantinë – Sylejman Mehulli, kryesues; Smrekonicë – Lorik Maxhuni, kryesues; Samadrexhë – Agron Përçuku, kryesues; Maxhunaj - Lorik Maxhuni, kryesues; Nedakoc – Ilmi Azemi, kryesues; Prelluzhë – Ilmi Azemi, kryesues; Stanoc i Epërm – Nurie Halili, kryesuese; Dumnicë e Llugës – Fakete Dushi, kryesuese; Skromë – Ilmi Azemi, kryesues; Gojbulë – Alban Bajrami, kryesues; Komuniteti i biznesit dhe fermerët – Lorik Maxhuni, kryesues; Grupet e ndryshme të grave – Melihate Basholli Latifi, kryesuese; Me Sportistë, rini dhe komunitetin artistik – Fatmire Cecelia, kryesuese; Me banorët e qytetit – Të gjithë anëtarët e KPF-së dhe Qeveria komunale.

Kurse, Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me qeverinë komunale caktojnë datën, orën dhe pjesëmarrësit tjerë në takimet publike me qytetarë.

3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kërkoi që për kuvend të na vjen lista e plotë e të gjithë aplikuesve, që ta dimë se a ka shkuar gjithçka në rregull procesi sipas rregullores. Pra, për hir të transparencës (nuk po paragjykojmë asgjë), ka qenë praktikë që edhe ata që nuk kanë përfituar, të jepet arsyetimi se pse nuk janë përfitues. Përndryshe, si sasi e përgëzoj këtë numër të nxënësve që janë përfitues për këtë vit.

Agim Miftari, zyrtar nga Drejtoria për Arsim – theksoi se për ata që nuk janë përfitues ne kemi dhënë një sqarim. Për kuvend do ta plotësojmë informatën me të dhëna që u kërkua nga anëtari i KPF-së.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Raportit dhe grantit të performancës për vitin 2020.

Islam Latifi, koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës – tha se ky raport përfshin periudhën janar – dhjetor 2020 dhe është i bazuar në metodologjinë standarde dhe në dokumentin kryesor të sistemit të performancës komunale. Ai tha se raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre për herë të parë u realizua përmes sistemit elektronik të menaxhimit të performancës komunale. Komuna e Vushtrrisë për vitin 2020 ka treguar një performancë mesatare, diku rreth 50%, ku për shkak të mos plotësimit të kriterëve minimale (mosrealizimi i buxhetit së paku 75%), nuk kemi qenë përfitues të grantit, e cila është një vlerë e konsiderueshme rreth 500 – 600 mijë euro.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – po shihet që komuna jonë për vitin raportues ka treguar një nivel jo të kënaqshëm. Ajo që më ra në sy është se nuk kemi asnjë çerdhe në nivelin rural ku e kemi përqindjen zero dhe kjo pastaj e ul përqindjen e përgjithshme. Prandaj, duhet të punohet në fushat ku kemi përqindje të dobët në mënyrë që të rritet performanca viteve të ardhshme.

Islam Latifi, koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës – theksoi se pas dy apo tre muajve do të publikohet raporti i performancës për vitin 2021 dhe komuna jonë prapë nuk do të jetë përfituese e grantit, për shkak se i kemi dy kriterë minimale të pa plotësuar: mosrealizimi i buxhetit së paku 75% dhe raporti i auditorit me qenë i pakualifikuar.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se aplikimet për legalizim janë rritur proporcionalisht në vitin 2021 në krahasim me vitet paraprake. Nëse ka mundësi të sqarohet kjo,

se a ka të bëjë kjo me fushatën parazgjedhore, apo komuna jonë ka përjetuar një lulëzim ekonomik gjatë vitit 2021, edhe pse ishte pandemia Covid 19.

Nexhat Merovci, nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – lidhur me pyetjen e parashtruar se pse është rritur numri i aplikimeve për legalizim në vitin 2021, Merovci sqaroi se kjo ka ndodhur për shkak se ka qenë një numër i madh i punëtorëve të angazhuar me kontratë mbi vepër, të cilët në të njëjtën kohë kanë bërë edhe një lloj fushate për aplikuesit dhe për këtë është edhe një numër më i madh i aplikacioneve të pranura në vitin 2021. Kurse, numri i objekteve të legalizuara nuk është i madh. Shpresojmë se në vitin 2022 do të kemi aplikacione edhe më shumë.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – theksoi se vitet 2017, 2018 dhe 2019 mungojnë në informatë. Prandaj, për kuvend të plotësohet.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë gjatë periudhës janar – qershor 2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

8. Rishqyrtimi i vendimit nr. 95/22 i datës 28.4.2022 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

9. Rishqyrtimi i vendimit nr. 96/22 i datës 28.4.2022 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

10. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe e KPF- së

